

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Shfrytëzimi i materialit drusor të pyjeve shtetëror në Bashkinë Kolonjë, viti pyjor 2025-2026”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

03413000-8 - Dru zjarri,

77211000-2 - Shërbime të lidhura me përpunimet drusore,

77211100-3 - Shërbime të korrjes së lëndëve drusore,

VLERA E FONDIT LIMIT: 7,695,823.53 (shtatë milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e njëzetë e tre pikë pesëdhjetë e tre) lekë pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Kolonjë** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 10.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Kërkesat e mësipërme bazohen me Nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të Nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik:

Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vertetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas percaktimeve të bëra në Shtojcën 9 të DST-ve (**Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit**).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar.

(shënim: plotësoni nëse është rasti, aktin konkret ligjor ose nëligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale në fjalë).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatori/et ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2022-2023-2024**, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e madhe se 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet**.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në **nenin 77 pika 3 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”**, ku parashikohet se: *“Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën”, “Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës”*.

si dhe bazuar në nenin **43, pika 2/c, nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”**, parashikohet se:

“Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

c) 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nënkufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”.

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

Duke marrë në konsideratë vlerën e fondit limit të kësaj procedure prokurimi, kërkohet që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë në kohë dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim, është argumentuar se vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e madhe se 40% e vlerës së fondit limit** dhe vendosja e këtij limiti nuk kufizon pjesëmarrjen e operatoreve ekonomike.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklarave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Autoriteti Kontraktor në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda **datës 31 mars të vitit pasardhës**, duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.” pasi tatimpaguesit (operatorët ekonomikë) kanë detyrimin të dorëzojnë në administratën tatimore brenda **datës 31 mars të vitit pasardhës** bilancin kontabël së bashku me anekset e tij, si dhe Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar në rastet kur plotësohen kushtet e parashikuara nga ligji.

2.2.2 Operatori/et ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2022-2023-2024**, të certifikuara nga autoritetet përkatese (Dega e Tatim Taksave) ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e balanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.2.3 Operatori/et ekonomikë ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitetet **për vitin 2024** (Sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore **dhe për vitin e fundit 2025 (këstet e maturuara).**

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimevetë nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 43, nenit 41, pika 5/ c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, në ligjin nr.131/2015 “Për QKB” i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 datë 03.05.2007 “Për QKR” i ndryshuar.

Meqenese operatorët ekonomik kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1.Operatori/et ekonomikë duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, **në një vlerë jo më të madhe se 20 %** të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet, të realizuar gjatë tri viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.**

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

(Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes të përcaktuara në akt marrëveshje).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë **në një vlerë jo më të madhe se 20 %** të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Kontrata e ngjashme është e domosdoshme për të vërtetuar eksperiencën e operatoreve ekonomik ofertues, me qëllim që të garantohet zbatimi i kontratës me sukses, pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikonin në ecurinë e punës së Autoritetit Kontraktor.

2.3.2 Stafi kryesor e mbështetës, punonjësit, çertifikimet

- a. Operatori/et ekonomikë duhet të paraqesë licencë të vlefshme të lëshuar nga QKL me Kod III.7.A Studim, projektim dhe zbatim në fushën e pyjeve dhe kullotave, Shërbime të ekspertizës dhe/ose profesionale lidhur me pyjet dhe / ose kullotat. *Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, të paktën njeri prej operatorëve ekonomik duhet të jetë i pajisur me leje , Kodi III.7.A.*
- b. Operatori/et ekonomikë duhet të paraqesë licencë të vlefshme të lëshuar nga QKL me Kod III.1.A Për ndikimin në mjedis, Autorizim mjedisor për aktivitetin : Shfrytëzim i lëndës drusore, përpunimin dhe tregtimin e saj. *Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, të paktën njeri prej operatorëve ekonomik duhet të jetë i pajisur me leje , Kodi III.1.A.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, nenin 41, pika 4, gërma a, si dhe ligjit nr.10 081, datë 23.02.2009, **“Për licensat, autorizimet dhe lejet e Shqipërisë”**.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente, për të siguruar asistencë të kualifikuar për shfrytëzimin e materialit drusor të pyjeve shtetëror në Bashkinë Kolonjë, viti 2023.

- c. Operatori/et ekonomikë pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate duhet të disponojë **stafin mbështetës**, si më poshtë:

NR	EMERTIMI	
1	Sharrëxhi	(2 persona)
2	Shofer	(2 persona)
3	Manovrator mjeteve të rënda	(1 person)

Për secilin duhet të paraqiten:

- Kontratë punë
- Të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë **minimalisht për muajin e fundit**.
- Shofer dhe Manovrator mjeteve të rënda duhet të jenë punonjës të specializuar për drejtimin e mjeteve të rënda dhe për këtë duhet të paraqesin dëshminë e aftësisë profesionale nga Drejtoria e Shërbimit të Transportit Rrugor.

ose

mund të jenë të kontraktuar me kontratë pune të rregullt për këtë procedurë prokurimi ku për secilin të paraqiten:

- Kontratë individuale të punës
- Shofer dhe Manovrator mjeteve të rënda duhet të jenë punonjës të specializuar për drejtimin e mjeteve të rënda dhe për këtë duhet të paraqesin dëshminë e aftësisë profesionale nga Drejtoria e Shërbimit të Transportit Rrugor.

***Në rastin kur makineritë dhe pajisjet disponohen me qera, Shofer (2 persona) dhe Manovrator mjeteve të rënda (1 person), mund të disponohen nga operatori/et ekonomik edhe nëpërmjet kontraktimit, për të cilët nuk është e nevojshme të jenë në listëpagesat e shoqërisë. (Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomike ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes të përcaktuara në akt marrëveshje).**

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme pika 2.3.2 gërma (c) janë përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kërkesa sa më sipër për Sharrëxhi është i nevojshëm për realizimin e shërbimit për prerjen e druve të zjarrit .

Kërkesa sa më sipër për Shofer është i nevojshëm për realizimin e transportit me mjete transporti tip **kamion** të druve të zjarrit nga parcela përkatëse deri në magazinën e Bashkisë Kolonjë,

ndërsa **Manovrator mjeteve të rënda** është i nevojshëm për hapjen e rrugëve pyjore me **Mjet germimi me goma** rrugë të cilat do jenë në shërbim të kamionëve për t’u krijuar lehtësi gjatë transportit të materialit drusor.

Autoriteti Kontraktor e vlerëson të nevojshme që operatori ekonomik duhet të disponojë punonjësit e kualifikuar si më sipër, pasi kjo kërkesë lidhet ngushtësisht me mjetet e kërkuara në **pikën 2.3.4**, të dokumentave të tenderit, në funksion të realizimit të kontratës objekt prokurimi, ku për drejtimin e mjeteve të vleresuara të domosdoshme për realizimin e punimeve në fjalë, nevojiten drejtuesit respektive, të pajisur me dokumentacionin përkatës, në përputhje me Kodin Rrugor dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.

2.3.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojëfuqi punëtorë prej **minimalisht 5 për muajin e fundit**, të vërtetuar me:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, **për muajin e fundit.**
- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi **për muajin e fundit.**

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.(Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit, **në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes të përcaktuara në akt marrëveshje).**

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtorë të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit,që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përlogaritur për proceset, veprimtaritë dhe shërbimet që janë të nevojshme për realizimin e shfrytëzimit të materialit drusor të pyjeve shtetëror në Bashkinë Kolonjë .

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr	Emri i mjetit	Njesi	Sasi	Statusi
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës min 7 – max 10 ton	copë	2	Në pronësi ose me qera
2	Motor share	copë	2	Në pronësi ose me qera
3	Sopate	copë	2	Në pronësi ose me qera
4	Mjet germimi me goma	copë	1	Në pronësi ose me qera

Të paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- Kokore minimumi 5 **(pesë) copë**
- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 5 **(pesë) copë**
- Komplet i ndimës së shpejtë minimumi 5 **(pesë) copë**
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 5 **(pesë) copë**.

Si dëshmi për plotësimin e kësaj pike Operatori/et ekonomik duhet të paraqese:

- Për mjetet me rrota/goma që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (lejë qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme).*
- Për mjetet e siguruar me qera, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik , siguracionin e mjetit,(të vlefshme). Për të gjitha mjetet e marra me qira, të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet afati i kontratës.*
- Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre,apo marrjen me qira te tij: aktet e zhdoganimit në Republikën e Shqipërisë ose faturat tatimore të blerjes.*

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicionmjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Kamion vetëshkarkues.

Mjet që përdoret për transportin e druve të zjarrit të nga parcela përkatëse deri në magazinën e Bashkisë Kolonjë, kërkohen 2 kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës min 7 – max 10 ton.

Motor share dhe Sopate - Pajisje që përdoren për prerjen e druve të zjarrit , kërkohen nga 2 (dy) copë për secilë pajisje.

Mjet germimi me goma Mjet që përdoret për hapjen e rrugëve pyjore të cilat do jenë në shërbim të kamionëve për t’u krijuar lehtësi gjatë transportit të materialit drusor, kërkohet 1 mjet germimi me goma.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike, Termave të referencës

Specifikimet Teknike, **Termave të referencës** për procedurën respektive janë hartuar nga komisioni i Përgatitjes së specifikimeve teknike dhe përlllogaritjes së fondit limit i ngritur me urdhër nr. **336** dhe nr. **3541** prot, datë. **15.07.2025**, pjesë përbërëse e strukturës së **Bashkisë Kolonjë**, në përputhje me nenin 36, të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 76 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Specifikimet Teknike janë pjesë e setit të dokumentave të ngarkuara në SPE për procedurën respektive.

Fondi Limit i përlllogarit është hartuar nga komisioni i përgatitjes së specifikimeve teknike dhe përlllogaritjes së fondit limit i ngritur me urdhër nr. **336** dhe nr. **3541** prot, datë. **15.07.2025**, pjesë përbërëse e strukturës së **Bashkisë Kolonjë**, sipas analizës së kostos “Për prodhimin dhe transportin e druve të zjarrit në parcelat pyjore të Bashkisë Kolonjë

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt: **“Shfrytëzimi i materialit drusor të pyjeve shtetëror në Bashkinë Kolonjë”**, Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurimin anëtar në NJP.

Bashkëlidhur këtij proces-verbali:

- Dokumentat e tenderit
- Specifikimet teknike, fondi limit dhe termat e referencës
- Grafiku i ekzekutimit,
- Projekti teknologjik

Njësia e Prokurimit